



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Study program **Agrobiznesi i qëndrueshëm**

Fakulteti Biznesi dhe Ekonomia

Cikli i studimeve Cikli i parë (Deridiplomike)

SETK 180

Përshkrimi i programit

Drejtimi i *agrobiznesit të qëndrueshëm*, ka për synim parësor t'i pajisë studentët me njohuri nga fusha e agrobiznesit, duke i aftësuar për të qenë kompetentë për të planifikuar politika të reja në këtë fushë, të cilat janë të rëndësishme për shtetin dhe për shoqërinë. Programi interdisiplinar i pajis studentët me njohuri të gjera nga fusha e agrobiznesit dhe me ndikimin e tij në shoqërinë globale. Ky program është fokusuar në agrobiznes, sjelljen e subjekteve të biznesit, aftësitë dhe operacionet. Programi është orientuar në zbatimin praktik të mjeteve, teknikave dhe koncepteve të tilla.

Drejtimi i *agrobiznesit të qëndrueshëm* ka për qëllim:

- T'i përgatisë studentët në zhvillimin e sipërmarrësisë në fushën e agrobiznesit përmes shfrytëzimit të resurseve vendore të tokës dhe fuqisë punëtore njerëzore.
- T'i përgatisë studentët që të ndërtojnë karrierë në sferën e agrobiznesit, por edhe në sektorin privat dhe joqeveritar, ta lidhë teorinë dhe praktikën që t'u mundësojë studentëve të fitojnë njohuri themelore për ndryshimet ekonomike, politike, shoqërore dhe teknologjike, të cilat e ndryshojnë mënyrën e jetesës dhe të punës.
- T'i rrisë aftësitë komunikuese dhe hulumtuese dhe të mundësojë fitimin e përvojave të reja në fushën e menaxhimit, marketingut dhe ekonomisë.
- Të ofrojë një sërë modulesh që përfshijnë bazën e njohurive për afrimin me profesionet, të cilat janë në zhvillimin e vetëdijes për mjedisin jetësor dhe realizimin e zhvillimit të qëndrueshëm me ndihmën e zhvillimit të bujqësisë.
- Zhvillimin e MSP-së me veprimtari bujqësore, ballafaqimin e suksesshëm në konkurrencë dhe adaptimin ndaj rregullativave të BE-së për mbrojtjen e konsumatorëve.
- Të krijojë kuadër të aftë, i cili do t'i udhëheqë kompanitë publike dhe private, si kuadër i cili profesionalisht është i aftë të bëjë analiza të përgjithshme dhe specifike në fushën e agrobiznesit dhe t'i elaborojë dallimet dhe nevojat e shoqërisë në tërësi nga aspekti shkencor dhe praktik.

Karriera

Në kuadër këtij drejtimi, studentët pajisen me njohuri nga të gjitha fushat relevante që kanë të bëjnë me agrobiznesin, zhvillimin dhe avancimin e shkathhtësive teknike, ndërpersonale, strategjike, analitike dhe komunikuese, si dhe ndikimin e tyre në shoqërinë globale. Studentët e diplomuar në këtë drejtim, përvetësojnë njohuri themelore për ndryshimet ekonomike, politike, shoqërore dhe teknologjike, të cilat janë në gjendje të ndryshojnë mënyrën e jetesës dhe të punës. Ata janë të aftë për të qenë të suksesshëm në kushtet e lira demokratike në ekonominë e tregut, duke u përfshirë në tregun ndërkombëtar të punës, të aftë për të menaxhuar kompanitë publike dhe private për të përmirësuar menaxhimin e agrobiznesit në vend, të aftë profesionalisht dhe kompetentë për të marrë pjesë në proceset integruese të vendit në Bashkimin Evropian.

Rezultatet e të mësuarit

Njohuritë dhe të kuptuarit

- Aplikim i diturive nga fusha e agrobiznesit duke u ballafaquar me problemet përkatëse në mjedise të reja;
- Studime të pavarura të tregut të agrobiznesit duke analizuar nevojat e tregut, planet për zhvillim, relacionet, destinacionet, çmimet, aktivitetet promovuese dhe shitjet;
- Punë në fushën e agrobiznesit;
- Përpilim dhe dizajnim i planeve si dhe zbatim i studimeve përkatëse të tregut me qëllim të sigurimit të të dhënave autentike për zhvillim të strategjive të agrobiznesit.

Aplikimi i njohurive dhe të kuptuarit

- Të demonstrojë njohuri dhe kuptim për lëndët e agrobiznesit dhe qëndrueshmërinë e saj,
- Të demonstrojë njohuri dhe të kuptojë problemet e agrobiznesit, të tilla si: zhvillimi i qëndrueshëm të agrobiznesit, ndikimi i agrobiznesit në mjedise, parimet e qëndrueshme të agrobiznesit , etj.

Aftësitë për të vlerësuar

- Të vlerësojë implikimet e marketingut për agrobiznes të qëndrueshëm, psh: dizajnimin e shërbimeve, të strategjive, çmimeve, promovimin efektiv dhe kënaqësinë e konsumatorëve në një mënyrë sistematike dhe kreative;
- Të jetë në gjendje të vlerëojë kushtet e tregut (pjesa e tregut, konsumatorët e synuar, mjedisin e njohur dhe atë të panjohur) në mënyrë që të planifikojnë prodhimet ose shërbimet, për të koordinuar aktivitetet e marketingut brenda kompanisë, kontrollin dhe monitorimin e këtyre aktiviteteve të njëjta në mënyrë të përsëritur brenda kompanisë;
- Të mendojë në mënyrë kritike për problemet e marketingut (produktin, çmimin, vendin, promovimin , njerëzit) si dhe situatën e biznesit në fushën e agrobiznesit.

Aftësitë e komunikimit

- Të paraqesë strategjitë e marketingut dhe planeve brenda organizatës, institucioneve dhe organizatave të ndryshme, duke përdorur formën e duhur të reklamimit;
- Të drejtojë dhe të inicojë aktivitete duke konsideruar planet dhe strategjitë për agrobiznes;
- Të zgjedhë mjetet e duhura të komunikimit, për promovimin dhe shitjen e produkteve / shërbimeve;
- Transferimi i njohurive të agrobiznesit te brezat e rinj.

Aftësitë e të mësuarit

- Identifikimi i nevojave personale, dhe zgjedhja e burimeve të përkatëse,
- Fitimi i aftësive dhe njohurive,
- Vetiniciativa për hulumtim të pavarur për nevojat e tregut në mënyrë që të plotësojnë nevojat dhe kërkesat e konsumatorëve.

Lista e lëndëve

Semestri 1

- [6.0 SETK] **Mikroekonomi**
- [6.0 SETK] **Agrobiznesi**
- [6.0 SETK] **Hyrje në biznes**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore - Të lira 1**

- [3.0 SETK] **Lëndë zgjedhore gjuhë Angleze 1**
- [3.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**

Semestri 2

- [6.0 SETK] **Mikrobiologjia**
- [6.0 SETK] **Fizika**
- [6.0 SETK] **Menaxhmenti i agrobiznesit**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore- Të lira 2**
- [3.0 SETK] **Lëndë zgjedhore gjuhë Angleze 2**
- [3.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**

Semestri 3

- [6.0 SETK] **Mikrobiologjia e ushqimit**
- [6.0 SETK] **Matematika dhe Statistika**
- [6.0 SETK] **Punë praktike**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore- Të lira 3**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore gjuhë Angleze për qëllime specifike**

Semestri 4

- [6.0 SETK] **Planifikimi në agrobiznes**
- [6.0 SETK] **Mekanizmi dhe proceset teknologjike**
- [6.0 SETK] **Punë praktike**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore 4/1**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore 4/2**

Semestri 5

- [6.0 SETK] **Prodhimet shtazore**
- [6.0 SETK] **Menaxhmenti strategjik në agrobiznes**
- [6.0 SETK] **Punë praktike**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore 5/1**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore 5/2**

Semestri 6

- [6.0 SETK] **Menaxhimi i cilësisë totale**
- [6.0 SETK] **Kualiteti i ushqimit dhe standardet për sigurimin e ushqimit**
- [6.0 SETK] **Punë praktike**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore 6/1**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore 6/2**

Description of courses

Lëndë obligative

- **Mikroekonomi**

Kjo lëndë ka të bëjë me hyrjen në parimet e makroekonomisë, shikuar si nga aspekti teorik, po ashtu edhe nga aspekti i zbatimit të tyre në degët e organizatës dhe të industrisë. Qëllimi është të shihet se si tregu bën alokimin e resurseve midis konkurrentëve të ndryshëm. Gjithashtu, tentohet të shihen anët e dobëta dhe të fuqishme të sistemit tregtar dhe shkaqet e intervenimit qeveritar në një ekonomi kapitaliste të tregut. Kjo lëndë ka për qëllim kuptimin e prodhimeve, vendimet konsumatore dhe të çmimeve të organizatave në kuadër të strukturave të ndryshme tregtare, përfshirë këtu një konkurrencë të përkryer, monopolin, konkurrencën monopol dhe oligopol.

- **Agrobiznesi**

Lënda Agrobiznesi është dizajnuar me qëllim për të njoftuar studentët me agrobiznesin, me mënyrën udhëheqjes së agrobiznesit, me procedurat dhe rregullat e agrobiznesit, me menaxhimin e agrobiznesit, mundësitë në agrobiznes,

etj.

- **Hyrje në biznes**

Lënda hyrje në biznes është dizajnuar me qëllim që studentët të njihen me rrethin e jashtëm dhe të brendshëm të ndërmarrjes. Me këtë rast, vëmendje do t'i kushtohet anës financiare, funksionit të marketingut dhe funksionit organizativ të ndërmarrjes. Përveç kësaj, do të shihet edhe ndikimi i ndërmarrjes ndaj bashkësisë në të cilën vepron. Kjo lëndë i njofton studentët me konceptet, modelet, debatet dhe problemet kyçe në studimin e biznesit dhe menaxhmentit. Studentët do të mësojnë për punën e shoqatave tregtare, funksionimin e tyre dhe bashkëpunimin me mjedisin. Me këtë lëndë, gjithashtu studiohet se si menaxhohen këto organizata të biznesit, përfshirë këtu edhe strategjitë të cilat janë shfrytëzuar për menaxhimin e tyre dhe vendimet e involuara në rolin e menaxherit.

- **Mikrobiologjia**

Në këtë lëndë studiohen bakteriet dhe viruset, sistematika e mikroorganizmave dhe taksonomisë, variabiliteti dhe gjenetika, filozofia, metabolizmi, bakteriologjia e aplikuar dhe patogjenetiku, imuniteti.

- **Fizika**

Kjo lëndë i njofton studentët me multiplikimin e ligjeve të fizikës, të cilët kanë të bëjnë me bujqësinë dhe mënyrën se si të rritet efekti i tyre dhe dobia nga to. Temat përfshijnë: mekanikën, kinematikën lineare dhe çarkulluese, dinamikën, statikën, ngrohtësinë, ndryshimet elektrike, makinat, vlerën relative, sjelljen e ujit, formimin e reve, mjegullat, borën dhe shiun, radiacionin termal, radioaktivitetin dhe zbatimin e tij në bujqësi etj.

- **Menaxhmenti i agrobiznesit**

Kjo lëndë është dizajnuar t'i njohë studentët me "gjuhën e menaxhmentit" (termet dhe teoritë) dhe rolin e menaxherëve në organizatë. Studentët do t'i zbatojnë njohuritë e fituara në studime të ndryshme të rasti, të cilat kanë të bëjnë me aspektet përkatëse. Kjo lëndë do t'i mbulojë: shkollat themelore dhe teoritë e menaxhmentit, të kuptuarit e menaxhmentit, menaxhmentin si proces dhe funksionet kryesore të menaxhmentit (planifikimi, organizimi, lidhshipi, motivimi, menaxhimi i resurseve njerëzore dhe kontrolli).

- **Mikrobiologjia e ushqimit**

Kjo lëndë është dizajnuar t'i mësojë studentët për lidhjet midis mikroorganizmave, kualitetit të ushqimit, ruajtjes së ushqimit të freskët dhe bioprocesimit. Kjo lidhet me lëndën e mikrobiologjisë të semestrit të parë.

- **Matematika dhe Statistika**

Përmes kësaj lënde studentët do t'i kuptojnë dhe do t'i zbatojnë elementet e statistikës deskriptive, të teorisë së gjasës të ndjekur me gjasat dhe shpërndarjen e kopjeve, llogaritjen e parametrave distribuivë, llogaritjen dhe kontrollin e hipotezave statistike, testimin e hipotezave, analizën e varianteve, analizën lineare dhe analizën e serive kohore, regresionin linear dhe korrelacionin.

- **Punë praktike**

- **Planifikimi në agrobiznes**

Kjo lëndë i pajis studentët me konceptin e planifikimit të biznesit, karakteristikat e planeve të biznesit dhe të identifikimit të sjelljes dhe vlerësimin e mundësive për zhvillimin e biznesit. Studentët do të jenë në gjendje të analizojnë disa studime rasti dhe përvoja praktike në këtë fushë.

- **Mekanizmi dhe proceset teknologjike**

Kjo lëndë u siguron studentëve njohuri lidhur me strukturën dhe funksionin e përdorimit më të shpeshtë të instalimeve mekanike të cilat kanë të bëjnë me sektorin e bujqësisë. Gjithashtu, në këtë lëndë do të studiohen edhe instalimet elektrike. Kjo lëndë ka një aplikim të madh praktik dhe u mundëson studentëve të mësojnë se si ta ruajnë një mekanizëm të tillë, si ta sigurojnë, si dhe si ta bëjnë sigurimin e lejes për menaxhimin me këto makina dhe mekanizma.

- **Punë praktike**

- **Prodhimet shtazore**

Kjo lëndë merret me sëmudjet e shtazëve, ndihmën e parë, specifikat e rrethit për rritjen dhe kultivimin kafshëve shtëpiake, biologjinë, ekologjinë dhe vlerën ekonomike të kafshëve. Gjithashtu, do të trajtohen edhe disa sëmudje, mutacione, mikroorganizmat fitopatogjenë, higjiena, kushtet sanitare, vaksinimi dhe procedurat e ngordhjes.

- **Menaxhmenti strategjik në agrobiznes**

Kjo lëndë është dizajnuar t'i njohë studentët me strategjitë e ndryshme si shkak për atë se pse organizatat i tejkalojnë konkurrentët e tyre dhe fitojnë një përparësi të caktuar konkurruese. Kjo lëndë nuk ka të bëjë kryesisht me planifikimin strategjik, por me analizën strategjike. Studentët do ta mësojnë procesin e menaxhmentit strategjik, duke filluar me formulimin e filozofisë dhe të misionit, vlerësimin e mjedisit të brendshëm dhe të jashtëm të organizatës dhe analizën e pozicionit konkurrues të ndërmarrjes e cila operon në sektorin bujqësor, metodat e analizave të këtij sektori dhe konkurrentët në suaza të saj, zhvillimin e planit dhe zbatimin e strategjisë.

- **Punë praktike**

- **Menaxhimi i cilësisë totale**

Qëllimi i mësimit të kësaj lënde është t'i aftësojë studentët për ta kuptuar esencën e menaxhimit të cilësisë totale, rëndësinë e tij dhe anët pozitive të shfrytëzimit të tij. Në kuadër të kësaj kënde, do të mësohet se çka paraqet cilësia, si të prodhimet po ashtu edhe të shërbimet, si dhe pasojat nga cilësia e keqe, dobia dhe cilësia. Më tej, do të mësohen drejtimet dhe teoritë e menaxhimit të cilësisë totale duke filluar nga autorët klasikë, perëndimorë dhe japonezë. Objekt studimi do të jenë edhe elementet e menaxhimit të cilësisë totale. Analizohen teknikat më të rëndësishme lidhur me menaxhimin e cilësisë totale dhe në fund studiohet mënyra e menaxhimit të cilësisë totale, si dhe kriteret e nevojshme për shpërblimet e njohura për cilësi në botë.

- **Kualiteti i ushqimit dhe standardet për sigurimin e ushqimit**

Sistemi i sigurimit të kualitetit mundëson aplikimin dhe verifikimin e masave kontrolluese, të cilat janë orientuar në sigurimin e ushqimit kualitativ. Këto janë të domosdoshme në secilën hallkë të zinxhirit të prodhimit të ushqimit.

- **Punë praktike**

Lëndë zgjedhore

- **Kimia**

Kjo lëndë ka të bëjë me njohuritë bazë të fushës së kimisë për qëllime bujqësore dhe është ndarë në: pjesën e përgjithshme, organike dhe inorganike. I përfshin temat për ndryshimet kimike të vendit, strukturën e atomit, hipotezën e Avogadros dhe zbatimin e saj, peshën molekulare, peshën ekuivalente, elektrolizën, acidet, substancat alkale, oksidimin, reduksionin e kështu me radhë.

- **Botanika**

Kjo lëndë i studion bimët, përfshirë këtu edhe strukturën e tyre, zhvillimin, gjenetikën, ekologjinë dhe evolucionin. Modulet laboratorike kanë të bëjnë me punën në terren dhe bërjen e eksperimenteve. Studentët do të trajnohen me shfrytëzimin e mikroskopit dhe përgatitjen e analizave të ndryshme për bakteriet, viruset, kërpudhat etj..

- **Marketingu i agrobiznesit**

Qëllimi i mësimit të kësaj lënde është që studentët të fitojnë njohuri nga fusha e menaxhimit të aktiviteteve të marketingut, rrethit të marketingut dhe dinamikës së tij dhe ndikimin stimulues ndaj punës së ndërmarrjeve që operojnë në sektorin e bujqësisë, vendimet e marketingut, të cilat menaxherët i bëjnë në lidhje me strategjitë të cilat i zbatojnë dhe pasojat nga ato strategji, planifikimin e marketingut dhe kontrollin e marketingut. Duke u nisur nga fakti se në qendër të vëmendjes së secilës ndërmarrje duhet të jetë konsumatori dhe nevojat dhe dëshirat e tij, është e nevojshme të sillen vendime të drejta të marketingut si në nivel të ndërmarrjes, po ashtu edhe në nivelet më të ulëta të organizatës.

- **Kontratat afariste**

Kjo lëndë studion zbatimin e të drejtës afariste në drejtim të plotësisimit të nevojave të veta dhe zhvillimit të karrierës. Disa nga temat që duhet të mbulojnë janë: historia e të drejtës, kontratat, marrëdhëniet midis punëdhënësit dhe

punëtorit, mbrojtja e konsumatorëve, instrumentet e negocimit dhe instrumentet tjera juridike. Kjo lëndë ofron edhe njohjen me bazat e sistemit të sotëm juridik dhe ndikimet e tij ndaj individëve. Studentët do të fitojnë njohuri dhe do t'i zbatojnë ato gjatë aktiviteteve të ndryshme në klasë në drejtim të zhvillimit të aftësive për mendim kritik. Temat përfshijnë: të drejtën, etikën, sistemin gjyqësor, kontratat, huatë, kërkesat dhe falimentimin.

- **Kimia ushqimore**

Kjo lëndë merret me natyrën dhe sjelljen kimike të përbërësve të ushqimit, përfshirë këtu proteinat, enzimet, pigmentet dhe elementet plotësuese që vihen në ushqim për t'i dhënë shije. Në këtë lëndë, theks i veçantë u është vënë ndryshimeve kimike dhe fizike të cilat ndodhin gjatë prodhimit të ushqimit.

- **Praktikat e mira bujqësore**

Rritja e sëmundjeve lidhur me prodhimet bujqësore krijon nevojën e një lënde të këtillë. Ndotja mund të ndodhë gjithkund në procesin e prodhimeve bujqësore, duke përfshirë edhe vendet ku ato shiten. Kjo lëndë fokusohet në praktikatat e mira bujqësore të cilat zbatohen në format dhe sipërfaqet e tokës punuese, si dhe në vendoret e paketimit, për t'u ulur rreziqet e dëmeve mikrobiologjike.

- **Praktikat e mira të prodhimit**

Praktikat e mira të prodhimit shfrytëzohen në prodhimin dhe testimin e prodhimeve ushqimore, sepse këto i shfrytëzojnë njerëzit. Ekziston një rregullativë e caktuar, e cila duhet të ruhet gjatë përpunimit të këtyre prodhimeve. Kjo lëndë i studion masat rregullative, si dhe zbatimin e tyre në studimet laboratorike dhe në proceset prodhuese.

- **Mjedisi jetësor dhe ekologjia**

Kjo lëndë studion marrëdhëniet midis mjedisit dhe ekonomisë, duke u fokusuar në atë se si ekonomia mund të identifikojë aspektet kryesore të problemeve mjedisore. Konceptet ekonomike janë përdorur për të gjetur një zgjidhje për ndotjen, menaxhimin e burimeve shoqërore, si dhe mundësinë e zhvillimit të qëndrueshëm.

- **Etika afariste dhe përgjegjësia shoqërore**

Kjo lëndë trajton normat etike dhe parimet e kompanive dhe rolin e tyre në shoqëri. Lënda konsideron aktivitetet e biznesit dhe praktikatat në drejtim të normave morale, në mënyrë që të realizojnë rezultate më të mira të biznesit. Qëllimi i lëndës është edhe shqyrtimi i rolit dhe funksionimi i etikës në biznes, metodat e analizave etike në shoqëri, etj.

- **Kontabiliteti për agrobiznes**

Kjo lëndë i përfshin këto tema: standardet ndërkombëtare të kontabilitetit, kapitalin, mjetet dhe rezervat permanente, mjetet financiare, detyracionet, letrat me vlerë, kërkesat e blerësve, kufizimet aktive kohore, detyrimet ndaj furnitorëve, rezervat afatgjata dhe afatshkurtra, kufizimet pasive kohore, rezervat materiale, prodhimet, mallin tregtar, shpenzimet materiale dhe jomateriale, shpenzimet e rrogave dhe amortizimin, konfirmimin e detyrimeve për TVSH-në dhe tatimin e fitimit, konfirmimin e rezultatit financiar, llogaritjen e shpenzimeve të prodhimeve dhe shërbimeve, llojet e shpenzimeve, llogaritjen dhe evidentimin e shpenzimeve direkte dhe indirekte, konfirmimin e shpenzimeve të punës së porositur (JOC), konfirmimin e shpenzimeve të procesit (PC), ndarjen e shpenzimeve indirekte në bazë të metodës ABC, pikën kritike e rentabilitetit (CVPA), buxhetin master, buxhetin fleksibil, buxhetimin kapital, kontrollin i shpenzimeve, qendrat e shpenzimeve, qendrat e profitit, qendrat e investimit, sjelljen e vendimeve afariste në bazë të informacioneve relevante etj.

- **Kapacitetet industriale dhe prodhuese dhe procesimi i të korrave**

Rëndësia e kulturave në të kaluarën, zhvillimi i tanishëm dhe i ardhëm i bujqësisë në botë, do të shihen në aspektin e prodhimit dhe blerjes. Temat do të trajtojnë çështje të tilla si: cilësia e mjedisit, popullsia në botë dhe uria, siguria e ushqimit, prodhimi dhe kështu me radhë. Gjatë leksioneve, studentët do të pajisen me parimet themelore të klasifikimit të bimëve dhe farërave, strukturën e bimëve, rritjen e të korrave.

- **Prodhimi dhe procedimi i qumështit dhe mishit**

Kjo lëndë merret me menaxhimin e fermave dhe marketingun e tipit të tillë të prodhimeve, trendeve prodhuese dhe kërkesave të blerësve. Fillon me prezantimin e proceseve fiziologjike në zhvillimin, rritjen dhe digjestionin, riprodhimin, laktacionin, si dhe mbeturinat gjenetike dhe fiziologjike të rrethit. Do të bëhen analiza dhe përgatitje të datotekave, organizimi dhe zhvillimi i prodhimeve të mishit, mbrojtja etj..

- **Prodhimi dhe procesimi i pemëve dhe perimeve**

Kjo lëndë merret me pemët e imta si: dredhëza, qershiza, ullinj, etj. dhe me prodhimin e tyre, teknologjinë, marketingun, ruajtjen dhe procesimin. Në pjesën praktike të lëndës, studentët do të planifikojnë, do të mbjellin, do t'i trajtojnë dhe do t'i zhvillojnë të mbjellat me prodhime të tilla. Në këtë mënyrë, studentët do të jenë të aftë të kënaqin kualitetin dhe kërkesat e eksportit të prodhimeve të tilla.

- **Analizat ekonomike në agrobiznes**

Lënda përqendrohet në analizën e kushteve ekonomike në agrobiznes, investimet potenciale si dhe mundësitë për zhvillimin e agrobiznesit, rolin i këtij sektori në ekonominë kombëtare. Temat përfshijnë analizën e aktiviteteve financiare dhe të investimeve, profitabilitetin, rritjen, vlerën ekonomike dhe vlerësimin e borxheve.

- **Sistemet e sigurimit të ushqimit**

Qëllimi kryesor i kësaj lënde është t'u sigurojë studentëve njohuri themelore nga roli i mjekësisë veterinerë në prodhimin e ushqimit të shëndetshëm, lidhur me produktet e mishit, qumështit, vezëve etj., si dhe disa sisteme për sigurimin e ushqimit të prodhuar nga bimët. Do të trajtohen edhe parimet dhe konceptet e programit HACCP, masat preventive të cilat mund të ndërmerren për sigurimin dhe mbrojtjen e produkteve ushqimore etj..

- **Menaxhmenti operativ i zinxhirit të furnizimit**

Lënda ka të bëjë me krijimin e prodhimeve dhe shërbimeve bujqësore dhe dërgimin e tyre te konsumatorët. Duke pasur parasysh se tërë kjo është veprimtaria plotë e organizatave, mund të konkludohet se menaxhmenti operativ ka vlerë të madhe në punën e organizatës. Prandaj, secili student duhet të ketë njohuri për rolin, qëllimet dhe aktivitetet e menaxhmentit operativ. Marketingu mund t'i gjejë konsumatorët dhe t'i informojë për prodhimin. Megjithatë, menaxhmenti operativ është ai që bart përgjegjësi për kënaqjen ose zhgënjimin e konsumatorëve nga të cilët varet tërë organizata.

- **Menaxhimi i prodhimit**

Lënda ka të bëjë me prodhimin dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe shërbimet. Temat e përfshira janë të lidhura me formimin e një produkti, me çmimet e përshtatshme të produktit, duke bërë një proces të krijimit të një prodhimi të veçantë dhe të një teknologjie të nevojshme për prodhimin e tij.

- **Menaxhimi i rrezikut në agrobiznes**

Lënda mbulon zhvillimet kryesore të koncepteve themelore dhe funksionet e kapitalit, ndërmjetësve të tregut, instrumenteve, parimet e organizimit dhe funksionimit, rolin e tyre në ekonomi në përgjithësi dhe në sistemin financiar të ekonomive kombëtare në veçanti. Këto tregje dhe instrumentet financiare janë të kohëve të fundit. Funksionojnë në ekonominë e zhvilluara perëndimore. Pamja dhe zhvillimi i tyre e tyre inkurajon zhvillimin e sektorit real, përdorimin optimal dhe alokimin e burimeve, kursen ndikimin makroekonomik dhe vlerat.